

**ELBASAN – NUSJA E BOTES**  
nga udhëpërshkrimi (*Sejihatnameja*) i Evlija Çelebiut

Robert Elsie

*Në nëntor të vitit 1670, udhëtari turk, Evlija Çelebi, vazhdoi rrugën e tij në Shqipërinë e Jugut. Pas vizitave në Gjirokastrë, Berat, Vlorë, Durrës dhe Kavajë, ai erdhi në qytetin më madhështore të Shqipërisë në atë kohë: Elbasani. Ky përshkrim i Elbasani – para më shumë se treqind viteve - është pa dyshim pika kulminante e udhëpërshkrimit të Evlija Çelebiut për Shqipërinë*

Bëmë 4 orë udhë mes për mes këtyre fshatrave derisa mbërritëm në çifligun e Hisim Mehmed Pashës bash në të dalë të Elbasanit, ku dhe u zbritëm kuajve për pak kohë. Prej këndeje, i çuam fjalë përfaqësuesit të guvernatorit të ejaletit të Rumelisë, Çorum Mustafa Pashës, se kishim mbërritur dhe kishim sjellë me vete dekretet perandorake për mbledhjen e trupave në mbrojtje të Manias. Përfaqësuesi mblodhi gjithë fisnikët dhe zyrtarët e lartë të Elbasanit, si dhe të zotët e zeameteve e të timareve, dhe doli përpara për të na pritur së bashku me një shpurë të madhe ushtarësh. Këta pastaj na shoqëruan me një vargan madhështor drejt një saraji të madh të qytetit, i cili u rezervohej bejlerëve. U mbajt një mbledhje e këshillit, ku u kënduan dekretet perandorake. E gjithë paria dhe zyrtarët e lartë i pranuan dekretet, duke thënë “Fjala e Padishahut është urdhër për ne” e duke u shprehur me lutje e bekime. Pastaj anembanë qytetit u dërguan tellallë për t’i njoftuar të gjithë të përgatiteshin për mbrojtjen e Manias. Ata më kërkuan një afat prej dhjetë ditësh. Unë pranova, por ngula këmbë që të mos humbisnin kohë dhe se doemos ditën e njëmbëdhjetë duhet të ishin gati për t’u nisur. “Fermani është i Padishahut,” thanë përsëri dhe i hynë punës.

Na doli se ky përfaqësues i Çorum Mustafa Pashës ishte vetë nga Elbasani dhe e quanin Xhemali-zade, një zotni i qeshur dhe mendjemprehtë. Ai në çast më shoqëroi nga sarajet e Pashait te saraji i tij i madh, ku na vendosi mua dhe shoqëruesit e mij në konakë të veçantë për mysafirë, duke na shtruar edhe gosti plot e përplot tri herë në ditë. E kaluam sa s’ka më mirë me qejflintë e Elbasanit si dhe bëmë kujdes që të shprehnim respektin tonë për njerëzit e shenjtë të qytetit, si dhe të shetitnim e të soditnim natyrën rretheqark.

*Kalaja e madhe dhe e lashtë e Elbasanit, nuse në këtë botë.* Sikundër qyteti i Antepit është nusja e Anadollit, ashtu edhe qyteti i Elbasanit është nusja e Shqipërisë në Rumeli. Sipas kronikanëve latinë, ky qytet i lashtë në fillim u themelua nga Filip Greku, sundimtari i kalasë së Kavallës, në kohën e Aleksandrit të Madh. Filozofë dhe magjistarë të panumërt kohësh të shkuara zunë vend për të banuar në këtë qytet dhe e bënë të lulëzojë. Në fund, pasi qe sunduar nga qindra mbretër e mbretëresha, trevat e Rumelisë ranë në gjendje anarkie, kurse ky qytet i madh ra në duart e dy bijve të Despotit Serb, që quheshin Bania e Basania, dhe u sundua prej të dyve së bashku. Mirëpo të dy vëllezërit grindavecë nuk qenë në gjendje të bënin përpara, sepse ndërmjet tyre shpërthyen grindje e përleshje. Në fund, Basania u lodh e u mërzit nga këto grindje dhe shkoi e gjeti strehë te Sulltan Mehmed Pushtuesi. Para syve të vetë Sulltanit ai ngriti gishtin tregues dhe bëri betimin monoteist, duke u kthyer kështu në fenë islame, ashtu sikundër e kishte udhëzuar Ak Shemshedini.

Kur ndodhej rrugës nga Shkupi për të pushtuar Shkodrën, Sulltan Mehmed Pushtuesi dërgoi drejt Elbasanit një pararojë prej 40.000 ushtarësh nën komandën e Koxha Mahmud Pashës. Duke patur si kallauz Basanian, tani me emrin mysliman Mehmed Bej, dhe pasi nënshtruan fshatrat rretheqark (*él-bas-*), një natë ata hynë në qytet. Mehmed Beu e gjeti të

vëllanë në gjumë dhe ia preu kryet, e kështu e fitoi qytetin e babait të tij me ndihmën e Mahmud Pashës e të osmanëve. Të gjithë të pafetë grekë e europianë të qytetit u shkuan në teh të shpatës. Sapo qyteti, krahina rrethëqark (él) dhe popullsia e vilajetit ranë në dorë (*bas-*) të Basanias, i quajtur edhe Mehmed Bej, qyteti u ripagëzua me emrin Elbasan (“Dhë-nënshtuesi”). Mirëpo ai quhet ---- në greqisht, ---- në frankisht dhe ---- në shqip. Kronikanët latinë japin edhe shumë rrëfime të gjata për këtë qytet, por ne e dhamë historinë e tij në mënyrë të përmbledhur.

Basania Mehmed Beu u nis me të shpejtë t’i sillte Sulltanit lajmin e mirë të pushtimit të qytetit prej tij. Sulltani e dëgjoi me kënaqësi atë lajm të mrekullueshëm dhe, duke e uruar, i dha Mehmed Beut të drejtën për të qeverisur atë qytet, i cili dikur kishte qenë i të atit. Sulltani, gjithashtu, e autorizoi të priste monedha sermi me emrin e tij, duke shfrytëzuar minierën e argjendit, si dhe të shtronte krahinën rrethëqark. Atëhere, i bekuari Ak Shemshedin, Emir Buhari dhe Mulla Gjyrani u lutën për pushtimin pa vështirësi të këtij vendi, duke kënduar një Fatiha për qëllimin e shprehur prej Sulltanit. Dhe pak kohë më pas, gjatë sundimit të Mehmed Pushtuesit e të Sulltan Bajzidit II të Shenjtit, vërtet ndodhi pushtimi i krejt Shqipërisë dhe i Hercegovinës.

Më vonë, sipas regjistrat administrativ të Sulejman Khanit, Elbasani u bë selia e beut të një sanxhaku të veçantë në vilajetin e Rumelisë. Për këtë has perandorak, beut iu caktua nga sulltani të sigurojë 201.963 akçe të ardhura. Elbasani ka 18 zeamete dhe 138 timare me një allajbej e një çeribash. Në kohë lufte, timariotëve u kërkohet me ligj të mbledhin një forcë prej 4.600 ushtarësh të zgjedhur e të armatosur. Sa herë që veziri i Rumelisë niset për luftë, me të shkon edhe sanxhak-beu i Elbasanit. Kryegjykatësi (dmth. kadiu) ka një nivel page prej 300 akçesh dhe mbulon ---- fshatra. Të ardhurat vjetore të kadiut janë 10 qese, kurse ato të beut 30 qese. Ndër zyrtarët e tjerë të lartë janë shejhyislami, nakibyleshraf, fisnikët, nën-kadiu i qytetit, inspektori i financës, tagrambledhësi, nëpunësi i vjeljes së taksës për frymë, qehajai i spahive, komandanti i jeniçerëve, dizdari i kalasë dhe gjithsej ---- trupa garnizoni, 5 agallarë të kalasë, kryearkitekti, qehajai i qytetit, si dhe shërbëtorët e pafë të kalasë, të cilët janë të përjashtuar nga taksat. Rajatë e pafë qeverisen nga 20 kryepaq qyteti (*portojuroz*). Elbasani ka një administratë të fortë e të disiplinuar. Si rajaja ashtu edhe qytetarët e lirë myslimanë respektojnë autoritetet dhe u binden atyre.

Sanxhaku i Elbasanit ka ---- kaza, ndër to Bashtovën e Myzeqenë në jug, Durrësin në perëndim, dhe ----. Gjithsej, sanxhaku ka 526 fshatra nën juridiksion. Shumë syresh janë të përjashtuar nga taksat, kurse shumë të tjera janë pronë shtetërore, kështu që bejlerët nuk mund t’u ndërhyjnë në punët e tyre.

*Kalaja e Elbasanit* gjendet në një fushë pjellore, e cila shtrihet nga veriu e nga jugu dhe përshkohet për një çerek ore. Kodrinat dhe malet përfaqësojnë të mbuluara me vreshta. Ky ndërtim i lashtë, drejtkëndësh e me strukturë të fortë, gjendet në një luginë të gjerë, në brigjet e lumit Shkumbin. Është 15 kut i lartë. Bedenat mbrojtës të jashtëm të kalasë janë të ndërtuara me mjeshtëri dhe kanë 50 kulla. Ajo është e rrethuar nga të gjitha anët me hendeqe të thellë sa dy shtate burri bashkë. Janë 50 kut të gjera dhe janë të mbushura me vreshta e kopshtije. Perimetri i kalasë është 2.400 hapa.

Kalaja ka 3 porta hekuri, një nga lindja, një nga perëndimi dhe një nga jugu në drejtim të Mekës, karshi kafeneve të pazarit. Kjo portë e madhe përdoret shumë dhe ka hyrje dyshe, si edhe të tjerat. Kalaja vetë ka mure dyshe dhe kjo është arsyeja që portat kanë dy koridore hyrjeje. Në qemerin përmbi portën jugore ose të pazarit, gjendet një bllok mermeri të bardhë, ku janë mbishkruar, me shkronja *xheli*, emrat e stërgjyshëve të Mehmed Pushtuesit deri te Osmanxhiku dhe data e pushtimit të Elbasanit: 859 (1455). Po ashtu, sipër kësaj porte, gjenden tre blloqe katërkëndësh mermeri të bardhë, varur në zinxhirë, ku duken gjurmë shigjetash e plumbash; kush hyn e kush del këndeje, të gjithë i venë re. Përmbi portë, në nivel kati të dytë, është xhamia e Hynqarit, një ndërtesë e vjetër prej guri, me çatinë me tjegulla. Afër xhamisë është një kullë sahati e lartë. Sahati është i ndërtuar me mjeshtëri të lartë dhe

është shumë i saktë, nuk luan as minutin e sekondën, prandaj dhe muezinët e të gjitha xhamive e ndjekin me besnikëri.

Brenda në kala janë 460 shtëpi të vjetra një- e dykatëshe, me mjaft hapësirë e me çati me tjegulla, por pa pjergulla e kopshte. Këtu gjendet shtëpia e dizdarit, por, me që Elbasani është në brendësi të vendit, nuk ka trupa garnizoni ose shtëpi për ta. Në vend të tyre është një kontigjent të paféshë, që shërbejnë në kala, e që prandaj janë të përjashtuar nga taksat.

*Qyteti jashtë mureve* shtrihet nga të gjitha anët e kalasë deri rrëzë kodrave një orë më këmbë larg. Sarajet e begata e plot dritë jashtë mureve të kalasë janë të hijeshuara me pjergulla të bukura, me kopshte si ato të parajsës, me lulishte, me çardakë e kënde kuvendimi. Janë me dy a tri kate, prej guri e me çati me tjegulla. Secila syresh ka çesëm me ujë të kulluar të rrjedhshëm dhe hauz e shatërvan që spërkat ujin nga sylynjarët. Janë banesa të rehatshme, si ato të kopshteve të parajsës. Në qytetin jashtë mureve të kalasë vetëm majat e minareve të xhamive janë të mbuluara prej plumbi; të gjitha ndërtesat e tjera kanë çati me tjegulla të kuqe.

Ndër shtëpitë e bukura të zyrtarëve të lartë janë saraji i vezirit Hisim Mehmed Pasha; saraji

i rezervuar për pashallarët; sarajet e Mustafa Agës, Memi Agës, Xhemali-zadesë, Kara Osman Agës, Hisim Mehmed Agës, Hisim Hasan Agës, Biçakçi-zadesë, Pasho-zadesë, si dhe ai i qehajait të spahive. Shkurt, sipas regjistrit të qehajait të qytetit, Elbasani ka 1.150 saraje e shtëpi të mrekullueshme. Pjesa tjetër janë shtëpi të rehatshme me bahçe për shtresën e mesme. Dyert e të gjitha këtyre shtëpive janë të hapura ditë e natë; madje, në qemerët e shumë hyrjeve mund të gjenden këto dy vargje arabe të shkruara me shkronja *xheli*:

“Për ty agu i ditës është i bekuar me lavdi e mbrohtësi,  
Dera jote është e hapur për të gjithë nevojtarët.”

Në hajatin e pritjes të disa sarajeve, në vend të tyre, mund të hasen këto dy vargje:

“Nderi i shtëpisë varet nga i zoti,  
Kurse nderi i të zotit varet nga bujaria e tij.”

Sikundër shihet nga këto vargje, si dhe nga mijëra të tjera si këto, të zotët e shtëpive në këtë qytet e kanë për turp të mbyllin dyert e të mbesin pa mysafirë ose të hanë bukë vetëm në prani të shërbëtorëve. Për këtë arsye, nuk ka shtëpi pa mysafirë e pa udhëtarë. Ata nuk mërzhiten prej tyre edhe kur këta të fundit vijnë me shërbëtorë e kuaj dhe qëndrojnë për gjithë muajin. Nëse u qëllon të jenë këtu në fund të vitit, mysafirëve u jepen rroba feste të përshtatshme. Kam dyzet vjet që udhëtoj, por kurrë nuk kam hasur një dashmirësi si kjo, me përjashtim të Hizir Agait, komandantit të jeniçerëve në Tripolin sirian, dhe të qytetit të Elbasanit.

Mëhallat. Qyteti jashtë mureve, i cili i ngjan kopshtit përrallor të Irem-it, ka 18 mëhalla me myslimanë dhe 10 mëhalla me të pafé grekë, shqiptarë e latinë. Nuk ka mëhalla me çifutë, frankë dhe armenë, ose me serbë, bullgarë e vojnukë. Nga këto grupet e fundit këtu vijnë vetëm për tregti, bujnë në hane dhe më pas largohen. Nëse vijnë me mendime që të zinin vend dhe të banojnë këtu, vriten menjëherë ky është zakoni i lashtë. Mëhalla në zë janë ---- dhe ----.

*Xhamitë e sulltanëve e të bamirësve osmanë.* Elbasani ka 46 faltore, nga të cilat më e vjetra është xhamia e Mehmed Pushtuesit, e ndërtuar sipër portës së kalasë, një godinë dykatëshe, me numër të madh besimtarësh që kryejnë ritet e faljes.

Në mesin e kalasë është xhamia e vjetër e madhe e Sinan Pashës, ngrehinë njëkatëshe. Faqet e jashtme të katër mureve të saj janë plotësisht të mbushura me dyvargëshe, vjersha, kaside, hadithe dhe njëvargësh, të mbishkruar nga udhëtarë të ardhur prej Turqie, Arabie e Persie, secili me dorën e vet, me bukurshkrim. Po të mblidheshin të gjithë së bashku,

mbishkrimet do të përbënin 100 vëllime. Në këtë xhami kanë ardhur mijëra vjershëtorë, të cilët janë munduar kush e kush të dëftejë mjeshtëri më të madhe vjershërimi se tjetri, prandaj muret jashtëzakonisht të sheshta, të lëmuara e plot dritë janë të mbuluara me krijime artistike të panumërta. Madje, në pajtim me zakonin tim të hershëm për të lënë gjurmë në çdo fshat a qytet a vend-faljeje ku shkoja, edhe unë kuturisa të shkruaja një dyvargësh e ta nënshkruaja: *Ketebehu seyyah-i'alem Evliya sene 1081* (E shkruar nga udhëtari nëpër botë Evlija, viti 1081/1670). Kronikanët u kanë vënë emra të veçantë çdo qyteti, kurse këtë Elbasan e kanë quajtur Shtëpia e Vjershëtorëve.

Kjo xhami e Sinan Pashës brenda në kala, me hapësirën dhe grigjën e madhe të besimtarëve për falje, ka një atmosferë hyjnore, por tani është mbushur plot e përplot me galeta për ushtrinë osmane, e cila po përgatitet të sulmojë kalanë e Kotorrit në tokat e Venedikut. Në të vërtetë, prej këtyre galetave, 100 kuintalë u ngarkuan në arabá dhe u dërguan në Durrës, e prej andej në Mania, me anije, për trupat osmane të atjeshme.

[Published in / Botuar në: *Albanica Ekskluzive: revistë mujore për dije e kulturë*, Prishtina, 69, June 2007, p. 79-81]